

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR PRANIMIN E INSTRUMENTIT TË AMENDAMENTIT TË KUSHTETUTËS SË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS, 1986”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon pranimin e amendamentit Kushtetues të ILO-s, për t’iu bashkuar 108 vendeve të cilat e kanë ratifikuar atë tashmë. Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e thirrur në Gjenevë nga organi qeverisës i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mbledhur në sesionin e saj të 72, më 4 qershor 1986, ka vendosur miratimin e disa ndryshimeve të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, që citohet si instrumenti i amendamentit të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, 1986.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet në Kushtetutën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës kanë të bëjnë me qëllimet themelore të Organizatës, selinë e përhershme të Organizatës, përbërjen dhe funksionet e organeve të saj kolegjiale, emërimin dhe përgjegjësitë e drejtorit të Përgjithshëm, dispozitat kushtetuese në lidhje me konventat dhe rekomandimet ndërkombëtare të punës.

Një shtet anëtar pranon këto ndryshime nëpërmjet dy instrumenteve, pranim ose ratifikim. Këto ndryshime referuar dhe nenit 36 të kësaj Kushtetute që do të hyjë në fuqi nëse ratifikohen apo pranohen nga $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të Organizatës.

Që ky amendament të hyjë në fuqi duhet të ratifikohet ose të pranohet nga 125 vende nga 187 që janë anëtare të saj.

Deri më tani (datë 24 qershor 2019) janë 110 vende të cilat e kanë pranuar apo ratifikuar këtë ndryshim. Kërkohen edhe 15 ratifikime apo pranime nga vendet përkatëse që ky ndryshim të hyjë në fuqi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin e brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Instrumenti i amendimit Kushtetues të vitit 1986 prek 4 fusha kryesore të Kushtetutës së ILO-s:

1. Përbërja dhe drejtimi i trupit drejtues (GB) të zyrës.

Sipas amendamentit të vitit 1986, numri i anëtarëve të trupit udhëheqës sipas Kushtetutës do të rritet nga 56 në 112, nga të cilët, 56 do t'u jepen përfaqësuesve qeveritarë dhe nga 28 secili përfaqësuesve të punëdhënësve dhe punëtorëve. Ndërkohë, nuk do të ketë më vende të garantuara për shtetet anëtare me rëndësi të madhe industriale.

2. Procedura e caktimit të drejtorit të Përgjithshëm.

Sipas amendamentit të vitit 1986, drejtori i Përgjithshëm do të vijojë të caktohet nga trupi drejtues (GB) por do të aprohet në Konferencën Ndërkombëtare të Punës.

3. Votimi në Konferencën Ndërkombëtare të Punës (ILC).

4. Rregullat e procedurës për amendimin e Kushtetutës.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE